



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:165906

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05548179

C.nr.1662/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, me bashkëpunëtorin profesional L.K. në çështjen juridike të paditësit D.K. me numër personal nga fshati komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. E.R. nga Prizreni, kundër të paditurit Sh. (Z) Sh. me numër personal nga fshati komuna e Prizrenit, me objekt të padisë dorëzimi i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro, gjykata pas mbajtjes së seancës kryesore publike, në të cilën prezantoi i autorizuari i paditësit dhe në mungesë të të paditurit me datë 20.03.2024, mori dhe më datë 04.04.2024 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.K. nga fshati komuna e Prizrenit. **DETYROHET** i padituri Sh. (Z) Sh. nga fshati komuna e Prizrenit, që t'ia dorëzoj paditësit D.K. nga fshati komuna e Prizrenit, në shfrytëzim dhe disponim të lirë pjesën e ngastrës kadastrale P-71813081-2454-0 ZK Hoçë e Qytetit, në sipërfaqe prej 25 m², në anën jugore të saj me masat dhe dimensionet nga lindja në kufi me ngastrën kadastrale 2455-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi prej 1.20 m, nga perëndimi në kufi me ngastrën kadastrale 2452-0 dhe 2453-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi prej 0.25 m, nga veriu bri murit të paditësit në vijë të lakuar në gjatësi të përgjithshme prej 25.91 m dhe nga jugu në kufi me ngastrën kadastrale 2450-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi të përgjithshme prej 25.41 m si dhe të lirojë duke e rrënuar objektin ndihmës në katshmëri P+0 të mbuluar me pllakë betoni në gjatësi prej 5.21 m dhe në gjerësi 1.20 m nga lindja dhe 1.18 m nga perëndimi, koshin për drithëra me konstrukcion druri në gjatësi prej 4.78 m dhe në gjerësi 0.70 m nga lindja dhe 0.35 m nga perëndimi si dhe tualeti(wc) e jashtme në gjatësi prej 2.12 m dhe në gjerësi prej 0.99 m nga lindja dhe 0.83 m nga perëndimi si dhe pjesën e murit rrethues të të paditurit i cili është ndërtuar nga bllokat e betonit në lartësi prej 2.0 m e në gjerësi prej 0.20 m e në gjatësi prej 0.25 m, i cili mur gjendet ngjitur me murin e paditësit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi D.K. nga fshati komuna e Prizrenit, përmes të autorizuarit të tij av. E.R. nga Prizreni, me datë 08.05.2013, pranë kësaj gjykate ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar në fjalën përfundimtare në shqyrtimin e datës 20.03.2024, kundër të paditurit Sh. (Z) Sh. nga fshati komuna e Prizrenit, me objekt të padisë dorëzimi i paluajtshmërisë, vlera e kontestit 3,100.00 euro.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.382/13 të datës 08.07.2016, është aprovuar e bazuar kërkesëpadija e paditësit D.K nga fshati Hoçë e Qytetit, komuna e Prizrenit, dhe vërtetohet se i njëjti është pronar i pjesës së parcelës kadastrale nr.2454-0 në vendin e quajtur Zabërgje e evidentuar sipas fletës poseduese për ZK Hoçë e Qytetit e cila në anën jug-lindore kufizohet me parcelen kadastrale 2450, pronë e Sh.Sh. e cila tani gjendet në posedim të paditurit e evidentuar sipas fletës poseduese për Z.K. Hoqe e Qytetit e cila në anën jug - lindore kufizohet me parcelen kadastrale 2450, pronë e Sh.Sh. e cila tani gjendet në posedim të paditurit pa kurrfarë arsye ligjore në masa dhe kufij sipas konstatimit të ekspertit dhe atë pika P 1 shkon në drejtim të parces kadastrale 2455-0, te pika 2, në gjatësi prej 13.84 m, dhe kthehet kah ana e djathtë në këndin prej 6 shkallëve dhe vazhdon në drejtim të njëjtë në gjatësi prej 11.80 m, pas kësaj në drejtim të jug lindjes në gjerësi prej 1.20 m te pika 4, pastaj në drejtim veri perëndimor të pikës 5, ku e përcjell kufiri në mes parc.kad. 2454-0 dhe 2450-0 sipas shënimeve kadastrale në gjatësi prej 14.48 m dhe te pika 7 me gjatësi prej 5.23 m pas kësaj kthehet në drejtim të pikës 1 në gjerësi prej 0.32 m ku mbyllet kjo sipërfaqe kontestuese prej 27.42 m, të cilën i padituri është i obliguar ta pranoj dhe sipërfaqen kontestuese prej 27.42 m² të ia dorëzoj paditësit në shfrytëzim dhe disponim të lirë dhe se në këtë sipërfaqe duhet të rrethohet muri rrethues dhe të hiqet objekti brenda sipërfaqes kontestuese të gjitha këto në afat prej 15 dite nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Me pikën II të dispozitivit e ka aprovuar si të bazuar propozimin e paditësit për caktimin e masës së sigurimit duke e urdhëruar të paditurin të mos e tjetërsoi, apo të ndërmarr veprime për të ndryshuar gjendjen faktike , deri sa të zgjidhet kontesti me vendim të formës së prerë. Me pikën III e ka detyruar të paditurin që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,517.90 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Gjykata e Apelit të Kosovës, me aktvendimin me shenjën Ac.nr.3747/17, të datës 16.10.2020, ka aprovuar të themeltë ankesën e të paditurit Sh. (Z) Sh. nga fshati Hoqe e Qytetit, Komuna e Prizrenit, është prishur aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.382/2013 të datës 08.07.20216 dhe lënda i është kthyer Gjykatës Themelore në Prizren në rivendosje.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij në padinë e parashtruar më 08.05.2013 dhe gjatë seancave gjyqësore ka theksuar se paditësi D.K. është pronar i parces kadastrale 2454-0 në vendin e quajtur "Zabërgje", ndërsa i padituri është pronar i parcelës kadastrale 2450, e në mes të këtyre dy parcelave ekziston muri kufizues në gjatësi prej 25.38 m, muri është ndërtuar në bazë të instruksioneve të paditurit me hamendje, mirëpo në bazë të matjeve të bëra dhe krahasimeve në vendin e ngjarjes është vërtetuar se muri nuk është ndërtuar në mezhde, kështu që një sipërfaqe e cila është pjesë përbërëse e parcelës kadastrale 2454, e cila i takon paditësit e që ka ngelur në anën tjetër të murit dhe i është bashkangjitur parces 2450 pronë e të paditurit të cilën i njëjti e shfrytëzon pa kurrfarë baze, sipërfaqja e cila ka mbetur në anën tjetër të murit është me dimensione prej 0 e shkon në 52 cm gjerësi, deri në 110 cm në tërë gjatësinë prej 25 m. Tutje ka shtuar se pas leximit të raportit plotësues të datës 02.02.2024, të punuar nga eksperti i gjeodezisë në shqyrtimin kryesor të datës 20.03.2024 ka bërë precizimin e kërkesë padisë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri Sh. (Z) Sh. nga fshati Hoçë e Qytetit, komuna e Prizrenit, që t'ia dorëzoj paditësit D.K. nga fshati Hoçë e Qytetit, komuna e

Prizrenit, në shfrytëzim dhe disponim të lirë pjesën e ngastrës kadastrale 2454-0 ZK Hoçë e Qytetit, në sipërfaqe prej 25 m², në anën jugore të saj me masat dhe dimensionet nga lindja në kufi me ngastrën kadastrale 2455-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi prej 1.20 m, nga perëndimi në kufi me ngastrën kadastrale 2452-0 dhe 2453-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi prej 0.25 m, nga veriu bri murit të paditësit në vijë të lakuar në gjatësi të përgjithshme prej 25.91 m dhe nga jugu në kufi me ngastrën kadastrale 2450-0 ZK Hoçë e Qytetit në gjatësi të përgjithshme prej 25.41 m si dhe të lirojë duke e rrënuar objektin ndihmës në katshmeri P+0 të mbuluar me pllakë betoni në gjatësi prej 5.21 m dhe në gjerësi 1.20 m nga lindja dhe 1.18 m nga perëndimi, koshin për drithëra me konstruksion druri në gjatësi prej 4.78 m dhe në gjerësi 0.70 m nga lindja dhe 0.35 m nga perëndimi si dhe wc e jashtme në gjatësi prej 2.12 m dhe në gjerësi prej 0.99 m nga lindja dhe 0.83 m nga perëndimi si dhe pjesën e murit rrethues të të paditurit i cili është ndërtuar nga bllokat e betonit në lartësi prej 2.0 m e në gjerësi prej 0.20 m e në gjatësi prej 0.25 m, i cili mur gjendet ngjitur me murin e paditësit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm. Edhe në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit ka deklaruar se mbetemi në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së ushtruar në gjykatë, pasi nga provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor është vërtetuar në tërësi kërkesë padia e paditësit. Andaj nga të lartcekurat ka kërkuar nga gjykata që kërkesë padinë e paditësit të aprovoj në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

I padituri Sh.Sh. në përgjigjen në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e parashtruar nga paditësi si të pabazuar, e njëjta nuk përmban kurrfarë prova përkitazi me arsyeshmerinë e kërkesëpadisë dhe si të tillë e kundërshtoj në tërësi, me arsyetimin se i padituri është pronar legjitim i ngastrave kadastrale 02450-0 dhe 02451-0, në sipërfaqen e përgjithshme prej 6470 m², ndërsa ngastra kadastrale 02452-0 në sipërfaqe prej 281 m² është pronë shoqërore, e cila kufizohet me ngastrat e të paditurit, ndërsa paditësi e ka uzurpuar një pjesë të pronës në vitin 1979 duke e shfrytëzuar si rrugë për një familje, pra rrugë jopublike. Në seancën përgatitore të datës 19.07.2022 dhe në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 05.10.2022 i autorizuari i paditësit ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke kërkuar nga gjykata që të veprohet sipas udhëzimeve dhe sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, me parashtrësën “për revokim të autorizimit” të datës 29.05.2023 i autorizuari i paditësit av. E.G. ka denoncuar autorizimin.

Gjykata seancën e vazhdimit të shqyrtimit kryesor të datës 20.03.2024 në kuptim të nenit 423.4 të LPK-së e ka mbajtur në mungesë të të paditurit Sh.Sh. pasi që është konstatuar se i njëjti është ftuar në mënyrë të rregullt.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, si dhe duke vepruar sipas vërejtjeve të Gjykatës së Apelit sipas aktvendimit Ac.nr.3747/17 të datës 16.10.2020, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 05.10.2022 dhe 20.03.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat relevante dhe atë: dëgjimi e paditësit D.K. në cilësi të palës; Ekspertizës të përpiluar nga eksperti K.G. e datës 23.11.2023 dorëzuar në gjykatë më datë 24.11.2023 si dhe raporti plotësues datës 02.02.2024 dorëzuar në gjykatë më datë 05.02.2024 së bashku me skicën e terrenit datës 02.02.2024 si dhe në përgjigjen e dhënë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren nr. 07-463/04-11787 e datës 29.01.2024 si dhe dëgjimin e ekspertit K.G. në shqyrtimin kryesor të datës 20.03.2024; Fletë posedimit nr. 021-30.11.2001; Skicës së matjes të punuar nga gjeodeti i licencuar

B.A.K. Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02451-0 ZK Hoçë e Qytetit; Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02450-0 ZK Hoçë e Qytetit; Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02452-0 ZK Hoçë e Qytetit; si dhe Certifikatën e datës 06.10.2022 për njësinë kadastrale 02454-0 ZK Hoçë e Qytetit.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e bazuar**.

Paditësit D.K. në cilësi të palës në shqyrtimin kryesor të datës 05.10.2022 ka deklaruar se murin përkohësisht e kanë ndërtuar para 20 viteve, ku kanë lënë hapësirë që në të ardhmen të ndërtojnë shtëpi me strehë dhe të punojnë në vendin e tyre. Mirëpo i padituri Sh.Sh. ka ndërtuar dy mure ngjitur me murin të cilin e ka ndërtuar paditësi, ka ndërtuar toaletin, ka vendosur koshin për misër, ka ndërtuar izëm (shpaizin) i cili shërben për vendosjen e bylmetit, si dhe ka deklaruar se nga i padituri po kërkon atë që është e tij sipas mëgjeve të përcaktuar nga kadastru.

Në Raportin e përpiluar nga eksperti K.G. e datës 23.11.2023, dorëzuar në gjykatë më datë 24.11.2023 ka theksuar se pas identifikimit të ngastrës 2454-0 ZK Hoçë e Qytetit është konstatuar në anën jugore të ngastrës nr.2454-0 Zk Hoçë Qytetit në kufi me ngastrën nr. gjindet muri nga bllokat e betonit me themel betoni në drejtim lindja –perëndim. Në anën jugore të murit në ngastrën nr.2450-0 i padituri ka të ndërtuar murin e paditësit në katshmeri P+1 ku në anën Veriore të shtëpisë gjindet objekti ndihmës ngjitur me murin e paditësit në katshmeriP+0 i mbuluar me pllakë betonit, një tualet dhe vazhdon deri tek dera e paditësit. Në këtë mure është i ngjitur edhe muri rrethues i të paditurit. Sipas gjendjes së fundit në operatin kadastral ngastra kadastrale nr.2454-0 Zk Hoçë e Qytetit në vendin e quajtur “Zabërgje- te shtëpia” me kulturë arë e kl (3) në sipërfaqe prej 556 m² evidentohet në emër të D.K. nga Hoqa e Qytetit, ndërsa sipas gjendjes së fundit në operatin kadastral ngastra kadastrale nr.2450-0 Zk Hoçë e Qytetit në vendin e quajtur “Zabërgje- te shtëpia” me kulturë shtëpi në sipërfaqe prej 60 m² dhe oborr në sipërfaqe prej 346 m² e në sipërfaqe të përgjithshme prej 406 m² evidentohet në emër të Xh.Sh. nga Hoqa e Qytetit. Ndër të tjera janë përcaktuar matjet në rast të marrëveshjes, pasi që i autorizuari i paditësit me parashtrësën dorëzuar në gjykatë më datës 09.08.2023 ka pretenduar se palët do të arrijnë marrëveshje. I autorizuari i paditësit në shqyrtimin kryesor të datës 20.03.2024 ka paraqitur vërejte në këtë raport sa i përket marrëveshjes pasi që e njëjta është tentuar që të arrihet nuk është arritur.

Nga dëgjimi i ekspertit të gjeodezisë K.G. në shqyrtimin kryesor të datës 02.02.2024 si dhe nga Raporti plotësues i datës 02.02.2024 gjykata ka konstatuar se pas matjes së gjendjes faktike në vend dhe koordinatave të kufirit në mes të ngastrave nr.2454-0 dhe 2450-0 ZK Hoçë e Qytetit të formuara nga planet kadastrale të Rilevizimit Aerofotogrametrik në vitin 1979 të cilat kanë hy në fuqi në vitin 1986 me të cilat disponon ZKK Prizren konstatoni se paditësi nga katërkufiri i ngastrave nr.2454-0, 2450-0, 2452-0 dhe 2453-0 nga dera hyrëse në drejtim të veri-lindjes deri tek kthesa në gjatësi prej 13.75 m duke vazhduar në drejtim të njëjtë me një kthesë të vogël nga lindja në gjatësi prej 6,95 m deri tek objekti ndihmës i të paditurit për të vazhduar në drejtim të njëjtë prej 5.21 m në tërë gjatësinë e objektit ndihmës e në gjatësi të përgjithshme prej 25.91m ka të ndërtuar murin rrethues nga bllokat e betonit në lartësi prej 1.80 m dhe 2.20 m e në gjerësi prej 0,20. Sipërfaqja kontestuese e pjesë së ngastrës nr.2454-0 nga muri deri në kufirin me ngastrën nr.2450-0 është 25 m² me masat dhe dimensionet nga lindja kufi

me ngastrën nr.2455-0 në gjatësi prej 1.20 m, nga perëndimi në kufi me ngastrën 2452-0 dhe 2453-0 në gjatësi prej 0.25 m, nga Veriu bri murit në vijë të lakuar në gjatësi të përgjithshme prej 25.91 m (13.75+6,95 +5.21 m) dhe nga Jugu në kufi me ngastrën nr.2450-0 në gjatësi të përgjithshme prej 25.41 m. Në sipërfaqen prej 25 m² të ngastrës nr.2454-0 ZK Hoçë e Qytetit i padituri në anën Lindore ka të ndërtuar objektin ndihmës në katshmëri P+0 të mbuluar me pllakë betoni në gjatësi prej 5.21 m e në gjerësi 1.20 nga lindja dhe 1.18 m nga perëndimi. Në vazhdim gjendet koshi me konstruksion druri i cili në ngastrën nr.2454-0 gjindet në gjatësi prej 4.78 m dhe në gjerësi prej 0.35 m nga Perëndimi dhe streha në gjerësi 1.37 m nga lindja dhe 1.00 m nga perëndimi si dhe tualeti (WC e jashtme) i cili në sipërfaqen kontestuese gjendet në gjatësi prej 2.12 m në gjerësi prej 0.99 m nga lindja dhe 0.83 m nga perëndimi. Paditësi në anën perëndimore të ngastrës nr.2450-0 ka të ndërtuar murin rrethues nga bllokat e betonit në lartësi prej 2.0 m e në gjerësi 0.20 m ,ky mur në sipërfaqen kontestuese gjendet në gjatësi prej 0.25 m.

Në skicën e terenti datë 02.02.2024 punuar nga eksperti K.G. konstatohet gjendja faktike në teren e paraqitur grafikisht ku me ngjyrën e kuqe gjendja paraqitet gjendja faktike, me ngjyrën e zezë kufirinë mes të ngastrave sipas planeve kadastrale dhe me ngjyrë të kaltër streha e koshti.

Nga leximi i përgjigjes së dhënë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren nr. 07-463/04-11787 e datës 29.01.2024 konstatohet ngastra 2454 Zk Hoçë e qytetit në sipërfaqe 556 m² evidentohet në emër të D.K. 1/1(ky ndryshim bërë sipas kontratës mbi shitblerjen Leg.nr.3558/2001 datë 18.09.2021) ku e njëjta vazhdon të evidentohet në emër të D.K. 1/1. Ndërsa ngastra 2450 ZK Hoçë e Qytetit evidentohet në emër të Z. (Xh) Sh. 1/1.

Nga leximi i fletë posedimit nr. 021-30.11.2001 dhe Certifikatës së datës 06.10.2022 për njësinë kadastrale 02454-0 ZK Hoçë e Qytetit gjykata ka konstatuar se ngastra kadastrale 2454 në sipërfaqe prej 556 m² evidentohet në emër të D.K. pjesa e pronës 1/1.

Nga shikimi në skicën e matjes të punuar nga gjeodeti i licencuar B.A.K. konstatohet fakti se matjet për këtë çështje janë realizuar edhe më datë 07.05.2023 nga eksperti B.A.K.

Nga leximi i Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02451-0 ZK Hoçë e Qytetit; gjykata konstaton se njësia 02451-0 ZK Hoçë e Qytetit evidentohet në emër të Z. (Xh) Sh.

Nga leximi i Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02450-0 ZK Hoçë e Qytetit, gjykata konstaton se njësia kadastrale 02450-0 ZK Hoçë e Qytetit evidentohet në emër të Z. (Xh) Sh.

Nga leximi i Certifikatës së datës 08.05.2013 për njësinë kadastrale 02452-0 ZK Hoçë e Qytetit gjykata konstaton se njësia kadastrale 02452-0 ZK Hoçë e Qytetit evidentohet në emër të Drushtvena Svojina javni i nekatégorisani putevi.

Gjykata me rastin e daljes në vend, së bashku me ekspertin e gjeodezisë K.G. – gjeometër dhe të autorizuarit e palëve në procedurë, ashtu siç është konstatuar në procesverbalin e datës 03.11.2022, ka konstatuar se në ngastrën me nr.2454-0 gjendet shtëpia e banimit me katshmëri P+1+NK, në anën jugore të shtëpisë gjendet objekti ndihmës i ngjitur për të , në vazhdim është muri nga bllokat e betonit në kufi me ngastrën kadastrale 2450-0 të cilën e shfrytëzon i padituri. Në anën lindore të murit është një

shup e mbuluar me pllak të betonit me katshmëri P+0, në murin e lartë cekur janë të ngjitur një tualet, një kosh për misër me themel betoni me konstruksion druri i mbuluar me llamarin dhe një shup për vendosjen e drunjtëve.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Gjykata pasi me kujdes ka vlerësuar secilën provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, si dhe pas analizimit të theksimeve të palëve ndërgjyqëse, ka ardhur në përfundim që duhet të vendoset si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për arsytet si në vijim:

Ligji Nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore” ku në nenin 93 parashihet se: *Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”. Ndërsa me nenin 18 të po këtij ligji parashihet se *“Pronësia është e drejta e tërësishtme në një send. Pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti”*.

Se paditësi D.K. është pronar i njësinë kadastrale P-71813081-02454-0 Zona Kadastrale Hoçë e Qytetit, në sipërfaqe prej 556 m² pjesa e pronës 1/1 gjykata e ka vërtetuar në bazë të Certifikatës së me numër 07-029-11385-22 Ç e datës 06.10.2022 e lëshuar nga Zyra Kadastrale në Prizren si dhe nga i përgjigjes së dhënë nga Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër në Prizren nr. 07-463/04-11787 e datës 29.01.2024.

Referuar nenit 46, paragrafin 1, të Kushtetutën e Republikës së Kosovës i cili përcakton se: *“E drejta e pronës është e garantuar”*, ndërsa në paragrafin 3 të nenit të njëjtë përcaktohet se: *“Askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona. Republika e Kosovës ose autoriteti publik i Republikës së Kosovës mund të bëjë eksproprijimin e pronës nëse ky eksproprijimi është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrashjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilëve eksproprijohet”*, e po ashtu referuar edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore me Protokollin 1, i cili parasheh se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtë për respektimin e pasurisë së tij. Askujt nuk mund t’i hiqet prona e tij, veçse për dobi publike dhe në kushte e parashikuar nga ligji, si dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”*, rezulton se prona si kategori kushtetuese gëzon mbrojtje edhe me instrumente ndërkombëtare.

Rrjedhimisht, duke u nisur nga përkufizimi ligjor i të drejtës së pronësisë, del se pronari mund të disponojë me sendin sipas dëshirës së tij, veçanërisht atë ta posedojë dhe ta përdorë, me atë të disponojë dhe të tjerët t’i përjashtojë nga çfarëdo ndikimi, nëse nuk kundërshtohet nga ligji ose nga të drejtat e një të treti. Ne drejtim të kësaj, në nenin 93 të ligjit për pronësi parashihet se: *Pronari mund të kërkojë kthimin e sendit të caktuar prej secilit i cili nuk ka të drejtë posedimi*”.

Andaj duke qenë se paditësi i njësinë kadastrale P-71813081-02454-0 Zona Kadastrale Hoçë e Qytetit, në sipërfaqe prej 556 m² pjesa e pronës 1/1, ndërsa nga provat e administruara dhe të elaboruara si më lartë e veçanërisht nga raporti plotësues i ekspertit të gjeodezisë K.G. i datës 02.02.2024 si dhe nga këqyrja në vend e gjykatës pra nga observimi drejtpërdrejt i gjykatës u vërtetua se në sipërfaqen prej 25 m² të ngastrës nr.2454-0 ZK Hoçë e Qytetit i padituri në anën Lindore ka të ndërtuar objektin ndihmës në katshmeri P+0 të mbuluar me pllakë betoni në gjatësi prej 5.21 m e në gjerësi 1.20 nga lindja dhe 1.18 m nga perëndimi. Në vazhdim gjendet koshi me konstruksion druri i cili në ngastrën nr.2454-0 gjendet në gjatësi prej 4.78 m dhe në gjerësi prej 0.35 m nga Perëndimi dhe streha në gjerësi 1.37 m nga lindja dhe 1.00 m nga perëndimi si dhe tualeti (WC e jashtme) i cili në sipërfaqen kontestuese gjendet në gjatësi prej 2.12 m e në gjerësi prej 0.99 m nga lindja dhe 0.83 m nga perëndimi. Paditësi duke qene pronar i paluajshmërië objekt lëndore, i njëjta bazuar në dispozitat e lartcekura ligjore e ka të drejtën që të kërkojë kthimin e sendit si dhe lirim nga objekte e ndërtuara nga i padituri në pjesën e ngastrës kadastrale kontestuese, për çka edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi po ashtu kundërshtimin e të autorizuarit të të paditurit, por këto pretendime nuk u morën parasysh pasi që janë vetëm të natyrës deklarative dhe nuk paraqesin kërkesë për të cilën do të mund të vendoste gjykata lidhur me të.

Gjykata analizoi edhe pretendimet dhe deklaratimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat nuk i morri për bazë pasi që nuk kanë ndikim në nxjerrjen e këtij aktgjykimi.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u muar sipas nenit 450 të LPK-së, pasi që pala paditëse si palë gjyq fituese nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, konform nenit 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
C.nr.1662/2020, datë 04.04.2024

Gjyqtari

Taulant Rexhëbeqaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.